VENDIM

Nr. 21, Datë 31.01.2017

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË "ENPI ENERGJI" SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma "d" të Ligjit Nr. 43/2015 "*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*" si dhe në zbatim të neneve 4, gërma "e"; 5, pika 1 gërma "e"; 10, pikat 1 dhe 3 të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*" të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të "*Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*", miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 31.01.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë "ENPI ENERGJI" sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:
Aplikimi i shoqërisë "ENPI ENERGJI" sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "*Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*" si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat "a", "b", "c"), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat ("a", "b", "c", "d", "e"), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat "b", "d"), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni Teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrke (neni 9 pika 4, gërmat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Adresa: Blvd "Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al
Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe sigurimeve shoqërore, (neni 9 pika 3 gërma "a"), do të njoftohet subjekti që në bazë të "R*regullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike*", t`i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licensimin e shoqërisë "ENPI ENERGJI" sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet Ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare .

Adresa: Blvd "Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023 Tel/Fax +355 42 22 963
Tirane Tel +355 42 69 590
E-mail erealb@ere.gov.al www.ere.gov.al

Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr. 21, Datë 31.01.2017

MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË "ENPI ENERGJI" SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____

Adresa: Blvd "Bajram Curri, Rr. Viktor Eftemiu 1023
Tirane
E-mail erealb@ere.gov.al
Tel/Fax +355 42 22 963
Tel +355 42 69 590
www.ere.gov.al